



# BULETINI

Shtator 2009

Numri 7/2009

## Përmbajtja

- Fillimi i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor për gjeneratën e dytë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë
- Tryezë diskutimesh: Risitë në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore
- Tryezë diskutimesh: Tryezë për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje
- Tryezë diskutimesh: Ankesa Vendimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me ankesën - Kufijtë e shqyrtimit të ankesës IGJK.
- Trajnim mbi Ligjin për marrëveshjen për praninë të fajësisë: IGJK-Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve
- Seminar. Ligji për investimet e huaja IGJK & Deloitte Consulting
- Tryezë dyditore në nivel ekspertesh LPJK : IGJK & UNDP
- Trajnimi për bashkëpunëtorë profesional ( të cilët punojnë në punëtori) IGJK-NCSC
- Trajnim i avancuar për gjyqtarët porotë IGJK
- Tryezë diskutimesh: Dhuna dhe Efikasiteti i luftës kundër kësaj dukurie IGJK & UNDP

## FILLIMI I PROGRAMIT FILLESTAR PËR ARSIMIM LIGJOR PËR GJENERATËN E DYTË TË KANDIDATËVE PËR GJYQTARË DHE PROKURORË



Me datën 16 shtator 2009 Instituti Gjyqësor i Kosovës organizoi ceremoninë solemne e cila shënoj fillimin e Programit Fillestar për Arsimim Ligjor për gjeneratën e dytë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm të Kosovës. Kjo ceremoni u nderua edhe nga, Presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu si dhe personalitete të tjera shtetërore të Republikës së Kosovës, udhëheqës të institucioneve gjyqësore, përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë që mbështesin sistemin gjyqësor dhe përfaqësues nga institucionet regjionale të trajnimit gjyqësor. Në hapje të ceremonisë, drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës, theksoj “sot po shënojmë vazhdimësinë e një kapitulli të ri në zhvillimet e Institutit Gjyqësor dhe sistemin gjyqësor të Kosovës. Për të arritur në këtë ditë për Institutin Gjyqësor të Kosovës ishte një rrugë e gjatë e vështirë dhe me plot sfida. Nga 325 aplikant sa iu nënshtruan Provimit Përgatitor/Hyrës, për këtë vit,

kandidatët me rezultatin më të lartë do të ndjekin trajnimet në Programin për Përgatitjen Profesionale të gjeneratave të ardhshme për gjyqtarë dhe prokurorë. Në bazë të ligjit, mënyra e vetme për t’u bërë gjyqtarë apo prokurorë është ndjekja e trajnimeve obligative të organizuara nga Instituti Gjyqësor i Kosovës”. Prof. Dr. Vesel Latifi, kryetar i Këshillit Drejtues të IGJK-së, në këtë ceremoni theksoj “përmes këtij programi trajnuet Instituti Gjyqësor i Kosovës do ta ndihmojë Sistemin Gjyqësor të Kosovës me gjyqtarë dhe prokurorë të rinj. Ky program shënon fillimin e një mënyre të re të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët paraprakisht do të përgatiten nga Instituti Gjyqësor e pastaj do të vazhdojnë procesin e emërimit përfundimtar në këto pozita. Edhe pse Instituti Gjyqësor i Kosovës është i pavarur, i themeluar me Ligj nga Kuvendi i Kosovës, aktivitetet e tij trajnuese i kryen në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë tha Prof. Dr. Vesel Latifi duke e falënderuar OSBE-në Misionin në Kosovë i cili edhe e ka themeluar Institutin si dhe të gjithë.

ZHVILLIM  
PROFESIONAL  
GJYQËSOR

## Tryezë diskutimesh: Risitë në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datën 17 shtator 2009 ka organizuar seminarin me temë **”Risitë në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore”**. Gjatë punës së këtij seminary u trajtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me risitë e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, dallimet në mes të dispozitave të vjetra dhe atyre të reja si dhe u diskutua për mënyrën se si t’i qasen gjyqtarët zbatimit praktik të dispozitave të reja të këtij ligji. Në cilësi të trajnuesve në këtë seminar ishin profesor të Fakultetit Juridik të UP-së dhe gjyqtarë me përvojë të cilët kanë marrë pjesë aktive në hartimin e këtij ligji. Përfitues të këtij seminary ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.



## Tryezë diskutimesh: Tryezë për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje



Me datë 18 shtator 2009 u mbajt një tryezë e diskutimeve për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje. Në këtë sesion trajnimi objekt trajtimi ishte hartimi dhe përmbajtja e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse nga organi kompetent dhe provat e paraqitura në kërkesën për kundërvajtje. Gjatë kësaj tryeze është prezantuar një rast praktik dhe duke e shfrytëzuar punën grupore të ndërlidhur me hartimin e kërkesës për një kundërvajtje konkrete, janë ngritur për diskutim çështje të ndryshme problematike si dhe janë diskutuar disa nga vështirësitë me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët për kundërvajtje gjatë praktikës së tyre. Përfitues kryesor të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.

## Tryezë diskutimesh: Ankesa Vendimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me ankesën—Kufijtë e shqyrtimit të ankesës.

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datë 22.09.2009, Organizoj Tryezën e Diskutimeve nga lëmia penale lidhur me **Ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë**. Temat të cilat u shtjelluan gjatë kësaj tryeze u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me sqarimin e pamundësisë së ndryshimit të mëvonshëm të aktgjykimit sa i përket vendimit mbi dënimin për shkak të mungesës së bazës ankimore si dhe shqyrtimi i elementeve dhe specifikave të ankesës. Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Më 22, 23, 24 shtator 2009, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve (OPDAT), mbajti seminarin tre-ditorë mbi Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë. Gjatë këtij sesioni tre-ditorë ekspertët e SHBA-ve kryesisht u përqendruan në ofrimin e një pasqyrimi të përgjithshëm mbi bazën ligjore të “Marrëveshjes për Pranimin e Fajësisë”, praktikën më të mira të pranim fajësisë nga shtetit i tyre dhe ndikimin që kjo marrëveshje mund ta ketë në reduktimin e ngarkesës së lëndëve. Vështrim i posaçëm gjatë këtij sesioni ju kushtua përmbajtjes konkrete të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, deklaratave të palëve në procedurë,

autorizimit për fillimin e negociatave formale, pyetësorit formal të pranimit fajësisë, si dhe detyrave dhe autorizimeve të prokurorit publik, gjyqtarit dhe avokatit mbrojtës gjatë negociatave për pranimin e fajësisë dhe arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Disa shembuj të këtyre formularëve u ofruan nga praktika konkrete e ekspertëve të SHBA-ve.

Puna në grupe ishte një ndër metodat kryesore përmes së cilës u zhvillua seminari në fjalë, ku pjesëmarrësit u caktuan në role të ndryshme për të negociuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë sipas procedurës së paraparë me ligj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët nga të gjitha rajonet e Kosovës.

### Seminar: Ligji për investimet e huaja IGJK & Deloitte Consulting



Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me **Deloitte Consulting të përkrahur nga USAID-i**, me datën 23 dhe 24 shtator 2009 ka organizuar seminarin dyditor me temën “**Ligji për Investimet e**

**Huaja**”. Qëllimi i këtij seminari ishte ofrimi i njohurive më të thella rreth parimeve dhe rregullave të cilat e përcaktojnë veprimtarinë e investitorëve të huaj në Kosovë. Vëmendje e posaçme iu kushtua raportit në mes rregullave ndërkombëtare dhe atyre kombëtare për investimet e huaja, mbrojtjes së investitorëve të huaj nga shpronësimi dhe ndërhyrjet tjera qeveritare, parimeve kryesore lidhur me kontestet që rrjedhin nga investimet e huaja si dhe çështjeve tjera ligjore lidhur me investimet e huaja që janë relevante për punën e përditshme të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjorë. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha rajoneve të Kosovës.

### Tryezë dyditore në nivel ekspertesh LPJK : IGJK & UNDP

Instituti Gjyqësor i Kosovës i përkrahur nga UNDP, me datën 25 dhe 26 shtator 2009 ka organizuar tryezën dyditore me temë “Ligji i ri për Procedurën Jokontestimore”. Gjatë punës së kësaj tryeze u trajtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me Ligjin e ri për Procedurën Jokontestimore siq janë: Shqyrtimi i përgjithshëm i risive të LPJK-së, Administrimi dhe shfrytëzimi i sendeve të përbashkëta, ndarja e sendeve dhe paluajtshmërive në bashkëpronësi, shqyrtimi i pasurisë trashëgimore, shpallja e zhdukjes ose e vdekjes së një personi, të provuarit e vdekjes, rregullimi i mezhdës dhe caktimi i kompensimit për tokën e eksproprijuar. Në këtë seminar vëmendja u përqendrua edhe në çështjen se si ti qasen gjyqtarët

zbatimit praktik të dispozitave të reja të LPJK-së. Qëllimi i këtij seminari ishte sqarimi i dispozitave të reja të LPJK-së, ndërsa përfitues ishin gjyqtarët e lëmisë civile.



## Trajnimi për bashkëpunëtorë profesional ( të cilët punojnë në prokurori) IGJK-NCSC



Instituti Gjyqësor i Kosovës me datë 28 dhe 29 shtator

2009 në bashkëpunim me USAID/NCSC ka organizuar një sesionin trajnues me temë **“Shkathtësitë esenciale për bashkëpunëtorët profesional të prokurorisë”**. Gjatë këtij sesioni trajnues dy ditor pas një vështrimi të përgjithshëm mbi sistemin e së drejtës penale nga këndvështrimi prokurorial, janë shtjelluar e diskutuar këto çështje: hartimi i aktakuzës, thirrja dhe mbrojtja e dëshmitareve si dhe veprimet me informatën konfidenciale. Po ashtu është diskutuar edhe lidhur me komunikimin dhe parimet themelore të tij, kodin e mirësjelljes për shërbyesit civil, marrëveshjen për pranimin e fajësisë si dhe për sistemin pilot të menaxhimit informatikë të lëndëve (SMIL).

## Trajnim i avancuar për gjyqtarët porotë IGJK

Instituti Gjyqësor i Kosovës me 29 shtator 2009 realizoi edhe një sesion trajnimi të nivelit të avancuar për gjyqtar porotë.

Në këtë trajnim u bë një analizim dhe pasqyrim i përgjithshëm lidhur me rolin e gjyqtarit porotë në procedurën penale, procedurën penale për të mitur si dhe procedurën civile. Po ashtu një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe çështjeve të respektimit të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtarët porotë. Përfitues të trajnimit ishin gjyqtar porotë të regjionit të Pejës dhe të Prizrenit.



## Tryezë diskutimesh: Dhuna dhe Efikasiteti i luftës kundër kësaj dukurie IGJK & UNDP



Instituti Gjyqësor i Kosovës i mbështetur nga UNDP,

Misioni në Kosovë, me datën **30 shtator 2009** ka organizuar tryezën e diskutimeve me temë **”Dhuna në familje”**. Gjatë punës së kësaj tryeze u trajtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë; zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë mbrojtjen nga dhuna në familje, shkaqet e vonësive në procedimin e lëndëve që lidhen me dhunën në familje dhe praktikën gjyqësore lidhur me këto raste.

Vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zgjidhjen e rasteve praktike nga kjo fushë si dhe qasjes së tyre gjatë zbatimit praktik të dispozitave ligjore lidhur me mbrojtjen nga dhuna në familje.

Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarë, prokurorë dhe përfaqësues të qendrave për punë sociale të të gjitha regjioneve të Kosovës .

**Adresa: Lagja e Spitalit, Rr. "Muharrem Fejza" p.n.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081  
+381 (0) 38 512 095  
[www.kjijudicial.org](http://www.kjijudicial.org)  
[info@kjijudicial.org](mailto:info@kjijudicial.org)**